



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit për shkeljen e rregullave ligjore në procesin zgjedhor të dorëzuar nga parashtrues i njohur, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 57-të, të mbajtur më 17.12.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-4031 nga viti 2021 e formuar pas pretendimeve për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, **NDËRPRITET**.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sepse në rastin në fjalë ndërsa me kërkesë të KSHPK-së ka vepruar organ tjetër kompetent dhe ka konstatuar se pretendimet t nuk u konfirmuan.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-4031 nga viti 2021, e formuar pas kërkesës numër 12-4031 / 1 nga 20.10.2021, e dorëzuar në KSHPK nga parashtruesi i njohur -----", me pretendime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor - Zgjedhjet lokale 2021. Përndryshe, në denoncim janë cekur pretendimet kundër drejtorit të -----për arsye të lidhjes së kontratave të punës dhe punësimit të personave në orar të caktuar të punës gjatë fushatës zgjedhore të filluar zyrtarisht, e cila sipas parashtruesit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Për verifikimin e pretendimeve dhe konstatimin e gjendjes faktike të rastit, KSHPK-ja i ka dërguar kërkesë Inspektoratit Shtetëror të Punës që të veprojë në kuadër të kompetencave ligjore dhe të kryejë inspektim të jashtëzakonshëm në institucionin publik të subjektit lidhur me ligjshmërinë e procedurave për lidhjen e kontratës së punës dhe punësimin e personave të caktuar me kohë të caktuar që janë realizuar/zbatuar gjatë procesit zgjedhor 2021. Ndaj kërkesës së KSHPK-së është vepruar janë pranuar informacione me dokumentacion të bashkangjitur dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të marrë është konstatuar:

Për rastin e raportuar është bërë kontroll i jashtëzakonshëm dhe është përgatitur procesverbal në të cilin nga mbikëqyrja në vendngjarje me punëdhënësin Institucioni Publik Komunal – ----- – Strugë me raport të inspektorit shtetëror të punës është konstatuar se:

- Punëdhënësi me punësim në bazë të ligjit ka punësuar gjithsej 62 persona, ndërsa me kontratë për punësim janë punësuar 6 persona për periudhën prej 01.08.2021 deri më 31.08.2021, dhe një person është punësuar me procedurë ligjore të orar të pacaktuar me kontratë pune nga 05.08.2021.

- Në periudhën prej datës 06.08.2021 – kur janë shpallur zgjedhjet lokale 2021 – është konstatuar se institucioni në fjalë si punëdhënës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me procedurat për lidhjen e kontratave për punësim dhe punësimin e personave të caktuar në orar të caktuar të punës. , d.m.th. për këtë periudhë nuk ka pasur punësime ndaj çfarë do baze.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se lidhur me pretendimet e denoncuara, me kërkesë të KSHPK-së, ka vepruar organi tjetër kompetent dhe me inspektimin e jashtëzakonshëm të kryer, pretendimet nuk janë vërtetuar për çka KSHPK ka vendosur si në dispozitë të këtij Vendimi.

KOMISIONI SHTETËROР  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi

Punoi: J.C.  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së